

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 21 PRILL 2022

Zonja Kryetare,

Zotërinj deputetë,

Të dashur qytetarë dhe qytetare, që ndiqni këtë seancë,

Këtu diskutohet për një vepër ujësjellësi, por natyrisht, asnjë deputet nuk mund të përqendrohet vetëm te një marrëveshje, për faktin e vetëm se ka bindjen e plotë se edhe ky investim do të përfundojë si investimet e tjera, do të përfundojë i plaçkitur, i grabitur nga organizata kriminale që është në pushtet dhe është faktuar katërçipërisht si e tillë. Kujt i duket çudi, do t'i rikujtoj një skenë gjatë fushatës zgjedhore. Edi Rama bashkë me zonjën Konomi u ngjitën në lartësitë e maleve të Krujës, inauguruan ujësjellësin, duartrokiten, madje pinë edhe me të njëjtën gotë ujin e burimit, sikur të ishte kurativ, por sot Kruja nuk ka ujë; sot qytetarët e Krujës (po të doni, po jua lexoj mesazhin e njërit prej tyre) nuk kanë ujë, madje nuk kanë ujë prej disa vjetësh; nuk kanë ujë as pas ndërtimit të ujësjellësit. Nuk kanë ujë, sepse bashkia bën para me botet e shpërndarjes së ujit, duke ndjekur shembullin e Tiranës.

Çështja e furnizimit të vendit me ujë është një çështje kapitale. Shqipëria është një vend i bekuar në këtë aspekt, sepse me burimet e saj, me një studim të bazuar, mund të çojë ujë në rubinet me rrjedhje të lirë në të katra anët e vendit. Vetë relievi i saj e bën të mundur që ultësira me potencialet e Vaut të Dejës dhe të malit të Tomorit të ketë ujë 24 orë dhe me një cilësi shumë të mirë. Mirëpo uji, rrugët, punët publike, mbeten, ripërsëriten, ritenderohen, sepse fondet vidhen dhe nuk investohen, sepse ndërtohet me çmime në punët publike të paktën 8 herë më të larta se sa ato të standardit europian. Në qoftë se një shkollë në standardin europian ndërtohet me 500 mijë euro, në standardin shqiptar ndërtohet me 3 milionë euro; në qoftë se 1 km rrugë në fushë në standardin europian ndërtohet me 2,1 milionë euro, në standardin shqiptar ndërtohet me 22 milionë euro, për të mos folur pastaj për zhdukjen e investimeve publike edhe kur janë mbi 100 milionë dollarë. Do t'u shpjegoj qytetarëve impiantin e përpunimit të ujërave të zeza në Tiranë. Gjatë vizitës së qeverisë shqiptare në Japoni qeveria japoneze miratoi një fond prej 120 milionë dollarësh për Shqipërinë në një akt shumë miqësor.

Shqipëria, si rregull, nuk është në zonat (se ka njëfarë ndarjeje midis vendeve të pasura), ku Japonia përqendron investimet e saj publike, por bëri përjashtim dhe institucionet e saj financiare i bënë një dhuratë shumë të madhe Shqipërisë. Që nga viti 2012 deri sot askush nuk di gjë për këtë projekt, që është 120 milionë dollarë. Kësaj i thonë: "vidh e vidh, se nuk ka të sosur". Projekti duhej të zbatohej brenda dy vjetëve; tenderi për projektin u përfundua, por as sot nuk dihet se ku është vepra. Por nuk është vepër e vogël, është 120 milionë dollarë. Kush vuri dorë mbi këtë financim bujar? Ku është vepra? Rikthe, rikthe, rikthe, që të vidhet sa më shumë. Për historik: u ndërtua impianti i parë i përpunimit të ujërave të zeza në Shqipëri, që ishte një financim i Bankës Gjermane dhe u inaugurua në dhjetor 2005. Imagjinoni se sa mbrapa ishim ne në trajtimin e ujërave të zeza! Pas shekuj e shekuj, inauguroni

impiantin e parë. Pas tij, me një projekt të qartë u inauguruan edhe 10 impiante të tjera në Korçë, në Vlorë, në Durrës, në Sarandë apo në Ksamil (në mos gaboj, njëren nga këto të dyja).

Në tërësi, përqendrimi i madh u bë në zonën e bregdetit. A e dini se çfarë ndodh me to? Ata bashkiakët socialistë i kanë mbyllur, nuk i vënë në funksion, sepse duan energji elektrike. Pra, nga një mundësi e madhe për të pasur një nga brigjet më të pastra pas inaugurimit të tyre, ne vazhdojmë, si në të gjitha kohërat, impiantet i kemi mbyllur dhe ujërat nuk i filtrojmë, nuk i pastrojmë. Nuk është për shkak të mungesës së ujit apo të fondeve, por është vjedhja me fondet shkaku themelor i katandisje në këtë situatë të furnizimit me ujë të qytetarëve. Pra, rritët tarifat me 40%, në një kohë kur e vërteta është: në qoftë se ka një mall që Shqipëria mund t'ua japë falas qytetarëve të saj, siç bën Austria, është uji i pijshëm, sepse është me bollëk, përkundrazi ju e rritët edhe atë për t'i grabitur dhe për të futur duart në xhepat e tyre. Uroj që ky investim të mos ketë fatin e të tjerëve, pra të mbetet një letër e vdekur dhe të tjerët të mbushin xhepat me fondet e tij.